


**FUQIZIMI JURIDIK NË
KOMUNITETIN NË PROCESIN
E DEINSTITUCIONALIZIMIT**

R A P O R T



Botues:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
përfaqësuar nga presidenti dr. prof. Gordan Kallajxhiev

Redaktore:

Uranija Pirovska,
drejtoreshë ekzekutive e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

Autore:

Bojana Jovanovska

Përkthyes:

Elizabeta Poljoska

Gusht, 2020

CIP - Katalogizacija vo publikacija
Nacionalna i univerzitetska biblioteka "Св. Климент Охридски", Скопје

347.921.8:[316.647.82:364-053.2-056.26/.36(497.7)](047)

347.921.8:[316.647.82:364-056.26/.36(497.7)](047)

ЈОВАНОВСКА, Бојана

Правно зајакнување во заедницата во процесот на
деинституционализација : извештај / [авторка Бојана Јовановска]. - Скопје:
Хелсиншки комитет за човекови права, 2020. - 22 ; 22 стр. ; 21 см

Насл. стр. на припечатениот текст: Fuqizimi juridik në komunitetin në
procesin e deinstitutionalizimit : raport / [autore Bojana Jovanovska].
- Обата текста меѓусебно печатени во спротивна насока

ISBN 978-608-4790-68-6

а) Деца со попреченост -- Правна помош -- Дискриминација -- Социјална
заштита -- Македонија -- Извештаи б) Лица со попреченост -- Правна помош
-- Дискриминација -- Социјална заштита -- Македонија -- Извештаи

COBISS.MK-ID 52167941



Ky produkt është përgatitur në kuadër të programit „Bazat për të ardhmen“ i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar me mbështetjen e Ambasadës britanike
Shkup. Përmajtja e këtij publikimi nuk i pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet ose qëndrimet e Qeverisë britanike dhe UNICEF.

This product is prepared within the programme "Foundations for the Future" funded by the UK Government with the support of the British Embassy Skopje.
The content of this publication does not necessarily reflect the position or the opinions of the UK Government and of UNICEF.

PËRMBAJTJA

HYRJE	1
AKTIVITETE	3
1. Bashkëpunimi me qendrat ditore.....	3
2. Fuqizimi i personave që kujdesen për fëmijë me aftësi të kufizuara.....	4
3. Ndërtimi i kapaciteteve për ofruesit e shërbimeve.....	10
4. Ndihma juridike falas.....	12
5. Ndërgjegjësimi i popullsisë	15
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	16

HYRJE

Ky raport u përgatit në kuadër të projektit “Fuqizimi juridik në komunitetin në procesin e deinstitutionalizimit” të cilin Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut e zbatoi si pjesë e programit “Bazat e të ardhmes”, i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës britanike Shkup dhe UNICEF. Qëllimi i këtij raporti është t’i përcjellë rezultatet e aktiviteteve të realizuara të projektit përmes të cilave lexuesi do të fitojë njohuri të caktuara në lidhje me situatën e realizimit të të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, por edhe të japë rekomandime për aktivitete të mëtejshme për mbështetjen e procesit të deinstitutionalizimit.

Procesi i deinstitutionalizimit është pjesë e reformave të sistemit të mbrojtjes sociale dhe parashikon fuqizim dhe mundësim të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, prindërit, kujdestarët dhe personat e tjerë të cilët kujdesen për fëmijët, të cilat janë një pjesë e rëndësishme e vetë procesit. Procesi e përfshin zhvillimin e formave jashtinstitutionale të kujdesit, të cilat në mënyrë të pashmangshme i përfshijnë ndihmën dhe mbështetjen e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara, me qëllim që të mbeten në komunitetin lokal ku jetojnë. Qendrat ditore janë një nga format e përkujdesjes dhe mbështetjes jashtinstitutionale për fëmijët dhe familjet e tyre, të cilat punojnë në bazë të qasjes dhe kujdesit individual. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut funksionojnë 32 qendra ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara intelektuale të moderuara dhe të rënda, të vendosura në zonat urbane që mundëson bashkëpunim të lehtë me të gjitha institucionet e tjera në nivelin lokal (kopshte, shkolla, institucione shëndetësore, etj.) dhe integrim për përdoruesit në komunitetin lokal.¹ Duke e pasur parasysh rolin e qendrave ditore në mbështetjen e procesit të deinstitutionalizimit, në kuadër të aktiviteteve të projektit u përfshinë gjithsej 6 qendra ditore nga 5 qytete të vendit, dhe atë:

- **Gostivar** - Qendër ditore për personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe fizike;
- **Kavadar** - Qendër ditore për personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe fizike;
- **Prilep** (dy qendra ditore) - Qendër ditore për personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe fizike “Xunica” dhe Qendër ditore për personat me paralizë cerebrale;
- **Shkup** - Qendër ditore për personat me paralizë cerebrale;
- **Shtip** - Qendër ditore për personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe fizike.

¹ http://www.mtsp.gov.mk/voninstitutionalna-zashtita-56c8ab2d-ed7f-4dec-82b1-7b61a3ab4b9f-ns_article-dnevni-centri.nsp

Sipas „Raportit për ndihmë juridike të siguruar“² të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut për periudhën gusht 2016-janar 2018, ndër grupet e qytetarëve, të drejtat e të cilëve janë shkelur dhe më së shpeshti ballafaqohen me diskriminim, janë dhe personat me aftësi të kufizuara. Edhe pse qasja në shërbimet të ndryshme në zonat e ndryshme duhet të jetë e në dispozicion njejtë për të gjithë qytetarët, situata aktuale nuk e tregon atë. Kur bëhet fjalë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, parimet e barazisë dhe jodiskriminimit fatkeqësisht jo gjithmonë merren parasysh. Si rezultat i këtyre përvojave, në fokusin e këtij projekti u vë pikërisht qasja e pabarabartë në shërbimet për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, brenda komuniteteve të tyre lokale. Prandaj, objektivat kryesore të projektit përfshinin:

- Fuqizim juridik për prindërit dhe personat të cilët kujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara në kuadër të komunitetit, nëpërmjet qendrat ditore;
- Sensibilizimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të zyrtarëve nga njësitë rajonale për ndihmë juridike falas në Ministrinë e Drejtësisë për punë me fëmijë dhe persona me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre;
- Ndërgjegjësimi dhe vizibiliteti për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, por edhe ndërgjegjësimi i qytetarëve të tjerë për barrierat shoqërore me të cilat përballen këta persona.

Përmes aktiviteteve në kuadër të projektit, prindërit dhe personat e tjerë të cilët kujdesen për fëmijë me aftësi të kufizuara do të mundën më lehtë t'i identifikojnë rastet kur janë shkelur të drejtat e tyre, por gjithashtu do të marrin informacione se si të veprojnë në ato raste dhe ku mund të drejtohen. Nga ana tjetër, duke ndërtuar kapacitete të zyrtarëve nga njësitë rajonale për ndihmë juridike falas, do të sigurohet ndihmë dhe mbrojtje në kohë dhe efikase në kuadër të komunitetit lokal në të cilin jetojnë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre. Mbështetja juridike do t'u ndihmojë fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre t'i realizojnë të drejtat dhe nevojat e tyre për funksionimin e përditshëm në shoqëri, gjë që do ta parandalojë nevojën për ndarjen e fëmijëve nga familjet, në mënyrë që ta mbështesin procesin e deinstitutionalizimit.

² Jadrovski, I., Čallovská Dimovska, N. dhe Jovanovska Kanurkova, J. (2018) Raporti për ndihmën juridike të siguruar, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/05/IZVESTAJ_ZA_PRAVNA_POMOS.pdf

AKTIVITETE

1. BASHKËPUNIMI ME QENDRAT DITORE

Duke pasur parasysh që qendrat ditore janë lidhja kryesore me përdoruesit, pra me familjet e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara, një nga aktivitetet fillestare të projektit ishte vizita të qendrave ditore, në terren. U realizuan gjithsej shtatë vizita në shtatë qendra ditore në pesë qytete të vendit.

Në kuadër të vizitave në terren, përveç mënyrës së organizimit të punës dhe kapaciteteve të cilat i ka në dispozicion çdo qendër ditore, u diskutuan edhe marrëdhëniet e punonjësve me përdoruesit, përkatësisht familjet e tyre, si dhe problemet me të cilat përballen. Duke pasur parasysh që bashkëpunimi i punonjësve me prindërit e përdoruesve të qendrave ditore është përgjithësisht i mirë, shumë shpesh punonjësit janë njoftuar me problemet me të cilat përballen përdoruesit dhe familjet e tyre, gjë që tregon për nivelin e konsiderueshëm të besimit të ndërsjellë.

Sipas të punësuarve, një nga problemet e shpeshta me të cilat përballen përdoruesit e qendrave ditore është kufizimi i transportit për dhe nga qendrat ditore, mospërfshirja e territorit ku ndodhet qendra ditore, si dhe transporti joadekuat për qëllimin e tij të duhur. Numri i përdoruesve shumë shpesh nuk korrespondon me kapacitetin hapësinor të qendrës ditore, veçanërisht në rastet kur e njëjta qendër ditore vizitohet nga përdorues të të gjitha moshave, gjë që është veçanërisht problematike për organizimin dhe kryerjen e punës individuale me përdoruesit.

Një pjesë e madhe e punonjësve mendojnë se prindërit e përdoruesve të tyre e shohin funksionin e qendrave ditore si kujdes primar, dhe vetëm një pjesë e vogël si një vend ku fëmijët me aftësi të kufizuara marrin trajtim, por edhe ku vetë prindërit marrin mbështetje (psiko-sociale).

Ende, vetëm një numër i vogël i fëmijëve që i vizitojnë qendrat ditore janë të përfshirë në shkollimin e rregullt dhe që nga fillimi i vitit shkollor, punonjësit i vunë në dukje problemet me të cilat përballen prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, veçanërisht në lidhje me të drejtën për të siguruar asistentë arsimorë.

2. FUQIZIMI I KAPACITETEVE TË PERSONAVE TË CILËT KUJDESEN PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Fuqizimi dhe mbështetja në realizimin e të drejtave

Një nga qëllimet e projektit ishte fuqizimi juridik i prindërve dhe personave që kujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara brenda komunitetit, kryesisht në bashkëpunim me qendrat ditore që ishin të përfshirë në aktivitetet e projektit. Për këtë qëllim, janë realizuar gjashtë trajnime për prindërit, kujdestarët dhe personat e tjerë që kujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara, me qëllim të fuqizimit të tyre për t'i kuptuar më mirë të drejtat e tyre në raste diskriminimi ose çfarëdo shkelje e të drejtave.

Gjithsej 53 prindër, kujdestarë, dhe persona të tjerë që kujdesen për fëmijët dhe/ose personat me aftësi të kufizuara morën pjesë në trajnime. Qëllimi kryesor i trajnimeve ishte që pjesëmarrësit të fitojnë njohuri se si ta dallojnë diskriminimin dhe rastet kur janë shkelur të drejtat e tyre dhe/ose të drejtat e fëmijëve të tyre, si dhe mënyrat dhe mekanizmat se si dhe ku t'i denoncojnë ato. Përveç kësaj, pjesëmarrësit e kishin mundësinë t'i ndajnë problemet me të cilat përballen dhe t'i diskutojnë mundësitë për zgjidhjen e tyre, së bashku me trajnerët ose këshilltaret juridike. Gjatë diskutimeve, u theksuan disa probleme që hasen më shpesh nga shumica e prindërve dhe personave që kujdesen për fëmijët dhe/ose personat me aftësi të kufizuara.

Një nga problemet më të zakonshme që pjesëmarrësit në të gjitha trajnimet e theksuan është mungesa e qasjes në infrastrukturë, duke filluar nga vetë institucionet, deri tek rrugët, trotualet, parkingjet dhe objektet publike. Mungesa e qasjes vazhdon të jetë problem serioz, edhe në rastet kur personi lëviz me shoqërues.

Sipas pjesëmarrësve, procesi arsimor është një problem me të cilin ende përballen fëmijët e tyre, përfshirë rezistenca për pranimin e fëmijëve të tyre në kopshte dhe shkolla të caktuara, si dhe transferimi i tyre i vazhdueshëm nga një institucion arsimor në tjetër. Mungesa e qasjes në institucionet arsimore dhe edukative është ende problem për shumë fëmijë me aftësi të kufizuara, duke e përfshirë edhe mungesën e qasjes në disa prej shkollave speciale. Në këtë drejtim, disa prindër shprehën mosbesim në lidhje me përfshirjen e plotë të fëmijëve në shkollimin, si dhe në lidhje me aplikimin e ICF-së. Shumica e pjesëmarrësve e theksuan nevojën për ekipe profesionale në të gjitha kopshtet dhe shkollat, si dhe ndihmën e fëmijëve që kanë nevojë gjatë ushqimit dhe/ose të shkuarit në tualet.

Shumë pjesëmarrës deklaruan se nuk janë mjaftueshëm të njoftuar me Ligjin e ri për Mbrojtjen Sociale, i cili u miratua në maj 2019, sidomos me ndryshimin e emrave të disa prej të drejtave, kurse disa prej tyre mendojnë se ligji i ri ua mohon atyre të drejtat që i kanë pasur më parë. Lidhur me Ligjin për Ndhimën Juridike Falas, pjesëmarrësit përgjithësisht nuk ishin të njoftuar me ligjin, përkatësisht me kushtet për ushtrimin e së drejtës për ndihmë juridike falas. Askush nga pjesëmarrësit nuk deklaroi se është drejtuar për ndihmë juridike falas në ndonjë nga zyrat rajonale të Ministrisë së Drejtësisë. Kur bëhet fjalë për miratimin e ligjeve të reja, pjesëmarrësit deklaruan se në mënyrë të pamjaftueshme, ndonjëherë dhe aspak, nuk merren parasysh nevojat dhe kërkesat e tyre. Kështu, për shembull, u theksuan kërkesat e tyre të vazhdueshme për ta lëvizur kufirin e moshës 26 vjeçe për personat me aftësi të kufizuara në aspektin e të drejtave sociale dhe të kujdesit shëndetësor, duke pasur parasysh se tek këta persona zakonisht bëhet fjalë për një gjendje të pandryshueshme, që me dispozita të tilla juridike i vë ato në situatë të pavolitshme.

Pjesëmarrësit në të gjitha trajnimet treguan një nivel relativisht të lartë të ndërgjegjshmërisë dhe aftësisë në dallimin e rasteve të diskriminimit dhe shkëlqes së të drejtave të tyre, madje edhe në raste të diskriminimit indirekt ose diskriminimit sipas asociacionit, por vetëm një pjesë e vogël nga ata thanë që i kanë denoncuar rastet në institucionet përkatëse, kurse një pjesë edhe më e vogël, në rastet kur kanë denoncuar, kanë qenë të kënaqur me procedurën e kryer, ose me rezultatin përfundimtar.

Shumica e pjesëmarrësve janë të dekurajuar t'i kërkojnë të drejtat e tyre para institucioneve, për shkak të mosreagimit të institucioneve në lidhje me nevojat dhe kërkesat e tyre. Në kuadër të të gjitha trajnimeve u përmend nevoja për një koordinim më të madh të institucioneve përkatëse, të tilla si Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, në mënyrë që të lehtësohen procedurat për ushtrimin e të drejtave të caktuara, veçanërisht kur bëhet fjalë për azhurnimin e dokumentacionit, rikategorizimit, në rastet kur bëhet fjalë për persona me gjendje të pandryshueshme.

Shumë pjesëmarrës deklaruan se nuk mund t'i gëzojnë të drejtat e tyre që u përkasin në punë, pavarësisht se ishin të njoftuar me të drejtat e tyre. Lidhur me të drejtat specifike, siç është e drejta për pagë për punë me kohë të pjesshme, pavarësisht që ishin të informuar, disa nga pjesëmarrësit kishin paqartësi në lidhje me mënyrën se si paguhet paga, kurse shumica thanë se ende kishin frikë se mos e humbin punën e tyre (veçanërisht nëse janë të punësuar në kompani private). Disa prej tyre as nuk kanë kërkuar kurrë që të përdorin disa nga të drejtat që u takojnë, edhe pse disa prej tyre tashmë kanë një dokument me të cilin mund të punojnë me kohë të pjesshme, kurse disa prej tyre që i përdorin ato kanë hasur probleme në punë, si ndryshim të pozicionit të punës ose ndryshim të ndërrimit.

Përveç trajnimit, për përdoruesit e qendrave ditore dhe personat që kujdesen për to u siguruan broshura për ndihmën juridike falas, dallimin dhe denoncimin e diskriminimit, si dhe ushtrimin e të drejtave në fusha të caktuara. Broshura *Ushtrimi i të drejtave përmes ndihmës juridike falas - Manual për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre*³ u përgatit me qëllim që të jepet përgjigje për disa prej pyetjeve më të shpeshta në lidhje me ushtrimin e të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre. Përmes shembujve të rasteve të diskriminimit, si dhe shembujve e të drejtave dhe ligjeve që janë çështje të interesit më të madh të këtyre personave, qëllimi i broshurës ishte të sigurojë informacion fillestar në lidhje me të drejtat e tyre dhe mundësitë për përdorimin e shërbimit të ndihmës juridike falas. Broshura gjithashtu i përmban dhe kontaktet e institucioneve përkatëse ku ata mund të denoncojnë shkelje të të drejtave të tyre, si dhe të kërkojnë një nga shërbimet e ndihmës juridike falas.

Broshurat, që janë në dispozicion në gjuhën maqedonase dhe shqipe, përveç në formë digjitale, do të jenë në dispozicion në formë të shtypur për të gjithë personat e interesuar nëpër të gjitha qendrat ditore në të gjithë vendin, si dhe me kërkesë përmes Komitetit të Helsinkit.

Mbështetja në shtëpi në kohë krize

Seminari *Mbështetja në shtëpi kur shërbimet nuk janë në dispozicion* e cila u mbajt në maj të vitit 2020, u krijua për t'i mbështetur prindërit dhe personat e tjerë që kujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara. Pandemia kishte një ndikim të rëndësishëm në jetën e përditshme të çdo familjeje dhe kontribuoi për ndryshimin e dukshëm të rutinave të zakonshme, jetës shoqërore, lirisë së lëvizjes. Masat parandaluese, siç janë distancimi shoqëror dhe vetizolimi, mund të jenë të vështira për t'u zbatuar në familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara, veçanërisht për shkak të faktit se disa fëmijë me aftësi të kufizuara varen pjesërisht ose plotësisht nga ndihma dhe mbështetja e personave të tjerë në plotësimin e nevojave të tyre të zakonshme. Për më tepër, një numër i madh i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre varen nga shërbimet që nuk ishin të disponueshme për ata gjatë kësaj periudhe (shërbime që ata i marrin në shkollat, qendrat ditore, qendrat e rehabilitimit dhe trajtimit, etj.), kështu që ata mund të kenë më shumë nevojë për mbështetje për kujdesin e fëmijëve në kushte shtëpiake. Duke e pasur parasysh gjithë këtë, fokusi i vetë seminarit u vë në rekomandimet specifike për prindërit për mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve të tyre në kushte shtëpiake gjatë periudhës së pandemisë.

⁴ Programi i seminarit përfshiu një prezantim më të mirë të modelit të ri të vlerësimit sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (ICF) përmes prizmit të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD). Duke marrë parasysh që ky model

³ <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/broshura-za-roditeli-albanski-za-na-veb.pdf>

⁴ <https://mhc.org.mk/news/povik-za-prijavuvanje-na-besplatna-onlajn-rabotilnica-za-roditeli/>

vlërësimi filloi të zbatohet në vendin tonë vitin e kaluar, me rëndësi të veçantë është që prindërit të marrin informacion të plotë dhe me kohë mbi metodën e vlerësimit dhe shërbimet mbështetëse që mund t'i marrin fëmijët me aftësi të kufizuara.

Seminari u mbajt në kuadër të dy moduleve që përfshinin tema të ndryshme në varësi të moshës së fëmijëve.

- **Moduli 1: Shtëpia – këndi im i preferuar i lojërave**, u mbajt më 26 maj 2020 dhe ishte dedikuar për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara të moshës 2 deri në 6 vjeç.
- **Moduli 2: Mësuesit e mi më të dashur – prindërit e mi**, u mbajt më 27 maj 2020 dhe ishte dedikuar për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara të moshës 7 deri në 14 vjeç.

Programi i të dy moduleve përfshinte disa tema që ishin përshtatur në mënyrë adekuate me moshën e fëmijëve për të cilët ata ishin dedikuar:

- Cilësia e jetës familjare në familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- Situata stresuese e shkaktuar nga COVID - 19 dhe mënyra se si e menaxhuam atë;
- Organizimi i jetesës në situatën e re: prezantimi i strukturës dhe orarit vizual të ditës, fuqizimi i aftësive të fëmijës për vetë-kujdes, zhvillimi i aftësive motorike në kushte shtëpiake, këshilla praktike për stimulimin e zhvillimit njohës;
- Perceptimi i fëmijës përmes prizmit të ICF-së;
- Perceptimi i aftësisë së kufizuar përmes një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut dhe Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Gjithsej 62 pjesëmarrës morën pjesë në dy modulet e seminarit. Interesi i madh për pjesëmarrje në seminar tregoi për nevojën për mbështetje të këtij lloji, veçanërisht nëse shërbimet që fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre i përdorin çdo ditë, mbeten të padisponueshme ose të kufizuara.

Me rëndësi është të përmendet se disa nga pjesëmarrësit në seminarin ishin persona që punonin në institucionet parashkollore. Sipas komenteve të këtyre personave, interesi i tyre për ta ndjekur këtë lloj përmbajtjeje buron nga mungesa e diturisë së tyre për teknikat dhe qasjen se si të punojnë me fëmijë me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të fitojnë aftësi që do të mund t'i aplikojnë në punën e tyre të mëtejshme në kopshtin e fëmijëve, ku janë të punësuar.

Informatorë për diskriminimin dhe informacioni mbi të drejtat e personave që kujdesen për fëmijë dhe/ose persona me aftësi të kufizuara

Duke pasur parasysh që deri tani përvoja në punën e Komitetit të Helsinkit e tregon faktin se shumë raste të diskriminimit në bazë të aftësisë së kufizuar nuk denoncohen, në kuadër të projektit u realizuan pyetësorë për personat që kujdesen për përdoruesit e qendrave ditore që ishin të përfshirë në projektin. Fokusi kryesor i këtij aktiviteti ishte përcaktimi i arsyeve më të shpeshta për shkak të së cilave viktimat e diskriminimit nuk e denoncojnë atë dhe çfarë do t'i ndihmonte ata në të ardhmen që të inicojnë procedurë para institucioneve përkatëse në rast diskriminimi dhe shkeljeje të të drejtave. Pyetësorët ishin të disponueshëm në dy gjuhë: maqedonisht dhe shqip dhe gjithsej 90 persona që kujdesen për përdoruesit e qendrave ditore e plotësuan pyetësorin, që është 77.6% të numrit të përgjithshëm të përdoruesve të gjashtë qendrave ditore të përfshirë me këtë projekt nga gjithsej 32 qendra ditore në vendin. 93.3% e të anketuarve jetojnë me një fëmijë dhe/ose një person me aftësi të kufizuara, kurse në raport me moshën, shumica e fëmijëve dhe/ose personave me aftësi të kufizuara për të cilët kujdesen të anketuarit janë nën moshën 18 vjeç, që do të thotë 53.8% dhe 18.7% janë nën moshën 26 vjeç.

Të dhënat⁵ që u morën nga pyetësorët e plotësuar i tregojnë përfundimet e mëposhtme:

- 55.6% e të anketuarve deklaruan se janë përballur me një situatë në të cilën kanë qenë të diskriminuar dhe/ose u janë shkelur të drejtat e tyre;
- Të anketuarit më shpesh përballen me diskriminim në arsimin parashkollor (42.5%) dhe mbrojtjen sociale (38.3%), shëndetësinë (34%), shkollën fillore (31.9%) dhe transportin publik (29.8%). Krahasuar me fushat e tjera, gati 40% tregojnë diskriminimin në një nivel të procesit arsimor;
- Nga të anketuarit që janë përballur me diskriminim, vetëm 36% e kanë denoncuar rastin, nga të cilët vetëm 37.5% kanë thënë se kanë qenë të kënaqur me procedurën;

⁵ <https://mhc.org.mk/sq/njoftime/diskriminimi-dhe-informacioni-mbi-te-drejtat-e-personave-te-cilet-kujdesen-per-femije-persona-me-aftesi-te-kufizuara/>

- Kur bëhet fjalë për arsyet e mosdenoncimit të diskriminimit, 29.8% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk besonin se ndonjë gjë do të kishte ndryshuar nëse do ta kishin denoncuar rastin, kurse pak më pak (21.3%) nuk kanë denoncuar për shkak të mosbesimit në institucionet. 17% nuk kanë denoncuar për shkak të frikës nga pasojat e dëmshme dhe 14.9% nuk kanë ditur se ku ta denoncojnë rastin;
- Shumica e tyre, që do të thotë 20% e personave që kanë denoncuar një rast diskriminimi, atë e kanë bërë në ndonjë nga organizatat joqeveritare, pastaj vijojnë gjykatat dhe Avokati i Popullit me 16% të rasteve të denoncuar, kurse policia dhe personat përgjegjës në institucionet ku ka ndodhur diskriminimi me nga 12%;
- Inkurajon fakti që pyetjes se çfarë do të kishin bërë nëse do të ishin përballur përsëri me një rast diskriminimi, 72% e të anketuarve thanë se do ta kishin denoncuar rastin. 69.5% e të anketuarve mendojnë se nuk kanë informacion të mjaftueshëm për atë se si të veprojnë në rast diskriminimi, ndërsa ata që kanë informacion të mjaftueshëm e citojnë median si burim më të zakonshëm (58.8%);
- Vetëm 27.6% e të anketuarve mendojnë se janë mjaftueshëm të informuar për të drejtat e tyre, kurse edhe më pak (16.1%) mendojnë se janë mjaftueshëm të informuar kur miratohen masa dhe ligje të reja;
- Lidhur me mënyrën në të cilën zakonisht informohen për të drejtat e tyre, për 44.4% e të anketuarve burimi kryesor i informacionit është media, ndërsa 18.5% informohen përmes prindërve/kujdestarëve të tjerë të fëmijëve dhe/ose personave me aftësi të kufizuara;
- Duke pasur parasysh që burimi më i zakonshëm i informacionit është media, sipas përgjigjeve e të anketuarve, më shumë se gjysma e tyre në përgjithësi më shpesh e përdorin internetin si burim informacioni (53.3%), ndërsa 17.8% e të anketuarve i citojnë konkretisht rrjetet sociale. Televizioni si burim i informacionit përdoret nga një numër më i vogël i të anketuarve, ose 26.7%.


3. NDËRTIMI I KAPACITETEVE TË OFRUESVE TË SHËRBIMEVE

Aktivitetet e projektit që kishin për qëllim ndërtim të kapaciteteve të personave që janë ofrues të drejtpërdrejtë të shërbimeve për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, i përfshiu punonjësit nga njësitë rajonale për ndihmë juridike falas në Ministrinë e Drejtësisë. Për atë qëllim, ishte planifikuar të kryheshin trajnime për zyrtarët për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre për ofrim të ndihmës juridike parësore. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte të rritet ndërgjegjësimi tek zyrtarët për problemet me të cilat përballen fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara dhe kujdestarët, veçanërisht barrierat me të cilat përballen në rastet kur kanë nevojë për ndihmë juridike. Njëkohësisht, me zbatimin e trajnimeve ishte planifikuar të kontribuohet në lehtësimin e aktit të përcaktimit të komunikimit fillestar me personat me aftësi të kufizuara, me se do të kuptohen më mirë kërkesat e tyre dhe do të jepet ndihmë adekuate juridike.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, në trajnimin morën pjesë gjithsej 45 zyrtarë nga zyrat rajonale. Programi i trajnimit u zhvillua nga ana e edukatores dhe rehabilitueses speciale për punë me fëmijë dhe persona me aftësi të kufizuara, si dhe këshilltares juridike nga Komiteti i Helsinkit, dhe kështu përfshiu disa tema kryesore:

- Karakteristikat dhe komunikimi me fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre;
- Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Barrierat në shoqëri për llojet e ndryshme të aftësive të kufizuara dhe mundësitë për eliminimin e tyre;
- Përvojat dhe këshillat në sigurimin e ndihmës juridike falas për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

Pas mbarimit të trajnimit, zyrtarët deklaruan se kanë nevojë për këtë lloj trajnimi edhe në fusha të tjera, por ata preferojnë që në të ardhmen trajnimet të mbahen drejtpërdrejt, gjegjësisht të shmangët organizimi i trajnimeve në internet, kryesisht për shkak të problemeve teknike me të cilat përballen gjatë këto lloj ngjarjeje. Duke pasur parasysh që shumica e zyrtarëve për herë të parë e hasin këtë lloj trajnimi për punë me personat me aftësi të kufizuara, me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëria e njohurive për punë me personat me aftësi të kufizuara, nevojiten përpjekje të mëtejshme për përfshirjen e trajnimeve të rregullta brenda programit për zyrtarët në njësitë për ndihmë juridike falas në Ministrinë e Drejtësisë.



Si material mbështetës për zyrtarët, u përgatit manuali *Ndihma juridike për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara – Udhëzues për komunikimin në ofrimin e ndihmës juridike për fëmijë dhe persona me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre*, i disponueshëm për përdorim të mëtejshëm gjatë punës. Qëllimi i këtij manuali ishte të shërbente si një udhëzues komunikimi për zyrtarët në ofrimin e ndihmës juridike për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, gjë që do të kontribuojë në sigurimin e ndihmës juridike efektive dhe në kohë për ata që e kërkojnë. Në bazë të përmbajtjes së këtij manuali, u përgatit dhe një video edukative e cila është në dispozicion për përdorim më të gjerë për të gjitha palët e interesuara përmes kanalit YouTube të Komitetit të Helsinkit.⁶

⁶ <https://www.youtube.com/watch?v=viA49XMJx3c>

4. NDIHMË JURIDIKE FALAS


Një nga aktivitetet e para me fillimin e këtij projekti ishte përgatitja e fletushkave informuese për ndihmë juridike falas *Përfshirje pa pengesa - Informacion mbi qasjen në ndihmën juridike të dedikuar për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre*⁷, të cilët përveç informacionit të përgjithshëm mbi llojet e ndihmës juridike falas dhe kushtet për përdorimin e saj, përfshinin edhe kontakte të shërbimit juridik të Komitetit të Helsinkit, si dhe institucionet përkatëse ku ata mund ta denoncojnë shkeljen e të drejtave të tyre. Fletushkat, të disponueshme në tre gjuhë: maqedonase, shqipe dhe rome, u dorëzuan në qendrat ditore dhe iu shpërndanë prindërve si pjesë e trajnimit për prindër.

Nëpërmjet shërbimit të ndihmës juridike falas që e mundëson Komiteti i Helsinkit, në periudhën nga gushti 2019 deri në korrik 2020, janë regjistruar gjithsej 13 raste të diskriminimit dhe shkeljes së të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara, ose prindërve të tyre dhe personave që kujdesen për ta.

Ndihma juridike është kërkuar në tre raste të lidhura me **mungesën e qasjes** në disa objekte dhe shërbime publike të caktuara. Në një nga rastet, prindi i një fëmije me paralizë cerebrale kërkoi ndihmë juridike në lidhje me mungesën e qasjes në shkollën speciale në të cilën mëson fëmija i saj. Në kuadër të këshillimit juridik, prindi na informoi se ajo është në komunikim të vazhdueshëm me personat përgjegjës në shkollë dhe se ka marrë informacion se do të ndërmerren veprime konkrete për përshtatjen adekuate të shkollës për nevojat e të gjithë nxënësve, me fillimin e vitit shkollor 2020/2021. Komiteti i Helsinkit do ta monitorojë këtë rast dhe do të reagojë në mënyrë adekuate nëse në fillim të vitit shkollor, shkolla nuk e përmbush detyrimin e saj.

Duke marrë parasysh se ndalimi i diskriminimit nuk u referohet vetëm personave me aftësi të kufizuara, por gjithashtu i përfshin edhe personat e prekur nga gjendja e tyre, përkatësisht anëtarët e familjes, kujdestarët dhe personat e tjerë që kujdesen për fëmijët dhe/ose personat me aftësi të kufizuara, në Komitetin e Helsinkit për ndihmë juridike gjithashtu aplikuan dhe disa **prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara** (pesë raste). Dy nga rastet ishin në lidhje me përdorimin e së drejtës për kompensim të pagës për punë me kohë të pjesshme për personat që kujdesen për një fëmijë me aftësi të kufizuara dhe pavarësisht se prindërit janë informuar për këtë të drejtë, ka ende paqartësi për mënyrën se si paguhet paga, por edhe një prani e dukshme të frikës nga problemet dhe humbjes së punës nëse ata kërkojnë ta ushtrojnë këtë të drejtë.


⁷ <https://mhc.org.mk/news/informacii-za-pristap-do-pravna-pomosh-nameneti-za-deca-so-poprechenost-i-nivnite-semejstva/>



Në një rast, një prind i një fëmije me aftësi të kufizuara u drejtua me kërkesë për ndihmë juridike sepse punëdhënësi i saj e kishte caktuar të punojë në një market që gjendej larg nga vendbanimi i saj. Kjo rishpërndarje për punëtoren do të thoshte vështirësi në kryerjen e detyrimeve të përditshme dhe në kujdesin për fëmijën e saj me aftësi të kufizuara, i cili vazhdimisht ka nevojë për mbështetjen e saj. Komiteti i Helsinkit i paraqiti një kërkesë punëdhënësit që ta kthejë punëtoren në vendin e saj të mëparshëm, pas së cilës punëdhënësi veprroi sipas kërkesës.

Një nga rastet i referohej një vizite në një nga qendrat shtetërore të rehabilitimit për të cilat rregulloret e Ministrisë së Shëndetësisë parashikojnë që personat me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për trajtim në banjat në vendin janë të liruar nga pagesat. Prindërit ose personat që kujdesen për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara e paguajnë vlerën e plotë të akomodimit në banjë. Por në këtë rast konkret, fëmija nuk mundet të kujdeset për veten e tij dhe ka nevojë të shoqërohet. Prindi është viktimë e diskriminimit edhe pse ai nuk diskriminohet drejtpërdrejt në bazë të aftësisë së kufizuar. Prandaj, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i rishikoi rregulloret që e rregullojnë këtë çështje dhe nëse ka diskriminim në këtë pjesë, ai do të kërkojë që institucionet kompetente t'i eliminojnë praktikatat diskriminuese.

Në dy raste u sigurua ndihmë juridike në lidhje me realizimin e **kompensimit me para** për aftësi të kufizuar, sipas Ligjit për Mbrojtje Sociale. Një nga rastet i referohej një personi me aftësi të kufizuara, gjendja shëndetësore e të cilit është e dëmtuar përgjithmonë për shkak të komplikimeve të rënda gjatë operacionit, që do të thotë se ka një aftësi të kufizuar fizike dhe intelektuale të përhershme. Si rezultat, personi nuk mund të punojë, as nuk mundet të kujdeset për veten e tij dhe t'i kryejë aktivitetet e përditshme të jetës. Edhe pse gjendja shëndetësore e personit është dëmtuar për gjithë jetën, ekipi nga Qendra për Punë Sociale kërkon që personi çdo vit të paraqesë dokumentacion dhe të paraqitet për kontrollë mjekësore për të përcaktuar nëse ai ende ka nevojë ta ushtrojë të drejtën e kompensimit me para për aftësinë e kufizuar. Personi i cili ka ndryshim ose ka shansë që gjendja e tij shëndetësore të ndryshohet, duhet të paraqesë dokumentacion ose të paraqitet për një kontroll mjekësor, në një interval të caktuar kohor, që të mund ta ushtrojë të drejtën e tij për ndihmë financiare nga mbrojtja sociale. Kërkesat e institucioneve që



personat me dëmtime shëndetësore të përhershme t'i nënshtrohen të njëjtës procedurë si të gjithë personat e tjerë, i vënë ata në një pozitë më të pavoritshme se të tjerët, që është diskriminim dhe përveç kësaj është një kërcënim serioz për pavarësinë e mëtejshme të të gjithë fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara.

5. NDËRGJEGJËSIMI I POPULLSISË

Me qëllim që të rritet ndërgjegjësimi dhe vizibiliteti për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, nga njëra anë, por edhe të ndërgjegjësimin të qytetarëve të tjerë në lidhje me barrierat sociale me të cilat përballen këta njerëz, Komiteti i Helsinkit nisi një fushatë digjitale në fokus të të cilave ishin dy video informuese ku u prezentuan disa nga pengesat në ushtrimin e të drejtave me të cilat përballen fëmijët me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për ta, si dhe informacionet e përgjithshme në lidhje me shërbimin e ndihmës juridike falas.⁸

Fushata digjitale u zhvillua gjatë muajit gusht të vitit 2020. Dy videot që u përgatitën si pjesë e kësaj fushate kishin për qëllim, nga njëra anë, ta rrisin ndërgjegjësimin e popullsisë së gjerë në lidhje me disa nga barrierat me të cilat përballen fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në funksionimin e tyre të përditshëm dhe nga ana tjetër, ta rrisin ndërgjegjësimin tek familjet në të cilat jetojnë fëmijët me aftësi të kufizuara, për të drejtat që ata i kanë në situata të caktuara. Njëkohësisht, videot informonin edhe për ekzistencën e shërbimit të ndihmës juridike falas dhe se ku ata mund të drejtohen ose të informohen për këtë shërbim. Duke marrë parasysh që një nga problemet më të zakonshme që i hasin fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre është në kuadër të procesit arsimor, një nga videot, me titull “Përfshirje pa pengesa”, përqendrohet pikërisht në këto barrierë.

Videoja e dytë, me titull “Kujdesje pa pengesa”, iu adresua prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në mjedisin e tyre të punës, duke i treguar barrierat më të zakonshme që ua vështirësojnë kujdesin për fëmijët, siç janë orari jofleksibël i punës, puna jashtë orarit dhe mungesa e mirëkuptimit nga ana e punëdhënësit në ushtrimin e të drejtave të tyre.

Këto video dhe e gjithë fushata pritet të kontribuojnë në inkurajimin e familjeve që t'i kërkojnë të drejtat e tyre, pra ta denoncojnë shkeljen e tyre duke e përdorur shërbimin e ndihmës juridike falas, veçanërisht përmes zyrave rajonale të Ministrisë së Drejtësisë, por njëkohësisht edhe për ta rritur ndërgjegjësimin e popullsisë së përgjithshme për të krijuar një shoqëri në të cilën secili individ mund të kontribuojë që të gjithë të mund të funksionojnë në mënyrë të papenguar.

⁸ <https://www.youtube.com/watch?v=VbzkXfUwq-Y>, https://www.youtube.com/watch?v=M2H0neJ5_wo

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Bashkëpunimi me qendrat ditore

Qendrat ditore dhe personat e punësuar në to treguan nivel të lartë të profesionalizmit dhe qasje për bashkpunim të hapur, me se u krijua një bazë e mire për realizimin e aktiviteteve të mëtejshme të përbashkëta për mbështjetjen e përdoruesve dhe familjeve të tyre.

Duke e pasur parasysh nivelin e lartë të besimit që e kanë përdoruesit dhe familjet e tyre tek personat që punojnë në qendrat ditore, rekomandohet që informacionet fillestare dhe kontaktet për shërbimin e ndihmës juridike falas të realizohen në bashkëpunim me vetë qendrat ditore. Prandaj, është e nevojshme të punohet për njohjen më të mirë të njerëzve që punojnë në qendrat ditore me informacione bazike për shërbimin e ndihmës juridike falas, si dhe për institucionet dhe organizatat që e ofrojnë atë në kuadër të komunitetit të tyre lokal.

Fuqizimi i personave që kujdesen për fëmijë me aftësi të kufizuara

Një numër i konsiderueshëm i njerëzve që kujdesen për personat me aftësi të kufizuara të cilët ishin të përfshirë në këtë projekt mendojnë se nuk janë mjaftueshëm të informuar për të drejtat e tyre, as për proceset e miratimit të masave dhe ligjeve të reja, duke shprehur pakënaqësi për përfshirjen e tyre të pamjaftueshme dhe mosmarrjen në konsideratë të nevojave dhe kërkesave të tyre në procesin e miratimit të tyre. Nga kjo vijon dhe shkalla e lartë e rezistencës dhe skepticizmi tek këta persona kur bëhet fjalë për miratimin e ndryshimeve ose ligjeve, masave, standardeve të reja etj., pavarësisht nëse bëhet fjalë për inovacione që synojnë t'ua lehtësojnë funksionimin e tyre të përditshëm.

Duke e marrë parasysh dekurajimin dhe mosbesimin e përgjithshëm për t'i kërkuar të drejtat e tyre para institucioneve përkatëse, është e nevojshme të punohet në forcimin e besimit tek personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në institucionet, si dhe në përfshirjen e tyre aktive në proceset e vendim-marrjes që kanë rëndësi të veçantë për ushtrimin e të drejtave të tyre, por edhe për plotësimin e nevojave specifike që ata i kanë. Duke e pasur parasysh që personat të cilët kujdesen për fëmijë dhe/ose persona me aftësi të kufizuara, si burim për informimin mbi të drejtat, dispozitat dhe masat e reja juridike më shpesh i përdorin mediat, saktësisht internetin, nevojitet transparencë më e madhe e këtyre proceseve, veçanërisht përmes këto lloj media.

Mbështetja e zvogëluar nëpërmjet shërbimet në periudhën e pandemisë, nga e cila varet një pjesë e madhe e fëmijëve me aftësi të kufizuara, e rriti nevojën për mbështetje për kujdesin e fëmijëve në kushte shtëpiake. Nëse kushtet të cilat fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre i përdorin në bazë ditore mbeten të paaritshme ose të kufizuara, duhet të sigurohen zgjidhje alternative për mbështetje për kujdesin e fëmijëve në shtëpi. Në atë kontekst, do të duhet të gjehen edhe zgjidhje alternative për qasje në shërbimet për ndihmë juridike falas që e sigurojnë organizatat dhe institucionet, në përputhje me kushtet.

Ndërtimi i kapaciteteve për ofruesit e shërbimeve

Duke qenë se zyrat rajonale për ndihmë juridike falas janë pjesë e Ministrisë së Drejtësisë dhe shpesh ndodhen në ndërtesat komunale ose ndërtesat e institucioneve të tjera lokale, personat me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për ta rrallë u drejtohen për ndihmë juridike. Kjo ndoshta është pasojë e shkallës së ulët të besimit në shërbimet në nivelin institucional, për çka nevojitet transparence më e madhe. Në atë drejtim, vetë projekti përfshiu aktivitete për promovim të njësive rajonale për ndihmë juridike falas, veçanërisht nëpërmjet informacionet në dispozicion me bashkëpunimin me qendrat rajonale lokale. Kjo është bazë e mire për bashkëpunim të mëtejshëm të njësive rajonale me qendrat ditore në sigurimin e mbështetjes juridike të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në kuadër të komunitetit.

Me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëri të njohurive për punë me persona me aftësi të kufizuara, është e nevojshme të bëhen përpjekje të mëtejshme për ta përfshirë trajnimin e rregullt brenda programit për zyrtarët në njësitë për ndihmë juridike falas në Ministrinë e Drejtësisë. Në atë drejtim, si material ndihmës mund të përdoren prodhimet që u përgatitën në kuadër të këtij projekti (manuali dhe videoja edukative).

Ndihma juridike falas

Në kontakt të drejtpërdrejtë, prindërit dhe personat që kujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara flasin relativisht lirshëm për problemet e tyre. Ata që kërkojnë ndihmë juridike falas fillimisht inkurajohen të ndërmarrin veprime të mëtejshme juridike. Sidoqoftë, shumica e tyre heqin dorë pas kontaktit të parë për shkak të mosbesimit në institucionet dhe mosqasjes në këtë shërbim.

Në mënyrë që të inkurajohen prindërit dhe personat që kujdesen për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara që së pari ta përdorin shërbimin e ndihmës juridike falas, ajo duhet të sigurohet brenda mjedisit të tyre dhe të zhvillohet në përputhje me nevojat e tyre. Për më tepër, siç u tha në rekomandimet e mëparshme, është e nevojshme të punohet në rritjen e besimit tek këta persona në institucionet, në mënyrë që të inkurajohen të ndërmarrin hapa të mëtejshme.

Prania e konsiderueshme e diskriminimit ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara brenda procesit arsimor ishte veçanërisht e dukshme me miratimin e Ligjit të ri për Arsimin Fillor në gusht 2019, zbatimin e të cilit filloi menjëherë me fillimin e vitit shkollor 2019/2020. Duke pasur parasysh që Ligji parasheh masa të reja për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore për të cilët padyshim që buxhetet komunale nuk ishin të përgatitur, nevojitet një koordinim më i madh i institucioneve përgjegjëse në mënyrë që fëmijët të mund t'i përdorin të drejtat e parashikuara nga ky Ligj. Për më tepër, institucionet përgjegjëse duhet shumë së shpejti t'i miratojnë të gjitha aktet nënjuridike në mënyrë që t'i eliminonjë mangësitë e lindura dhe ta sigurojnë zbatimin adekuat të Ligjit, në mënyrë që t'i përfshijnë fëmijët me aftësi të kufizuara në procesin arsimor në çdo aspekt. Prandaj, zbatimin e masave juridike duhet të përqendrohet më shumë në sigurimin e qasjes në shkollat dhe në mësimdhënien, përgatitjen adekuate të mësuesve për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbështetjen profesionale në secilën shkollë, sigurimin e materialeve adekuate mësimore, por edhe zbatimin e aktiviteteve për ta rritur ndërgjegjësimin për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në procesin e rregullt arsimor.

Ndërgjegjësimi i popullsisë

Përkundër faktit se në vendin ekzistojnë zgjidhje juridike relativisht të mira me të cilat janë rregulluar të drejtat e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara, si dhe standardet për sigurimin e qasjes në të mirat dhe shërbimet publike, zbatimin e tyre është ende në një nivel shumë të ulët, duke filluar nga qasja fizike deri në infrastrukturën dhe në përdorimin e shërbimeve publike, që ende është pengesë serioze për funksionimin e përditshëm shoqëror të personave me aftësi të kufizuara, por edhe të personave që kujdesen për ta.

Duke marrë parasysh që aktivitetet e ndërgjegjësimit pritet të kontribuojnë në inkurajimin e familjeve për t'i kërkuar të drejtat e tyre, pra për ta raportuar shkeljen e tyre, vetëm disa ditë pasi u shfaq videoja "Përfshirja pa pengesa", disa prindër iu drejtuan Komitetit të Helsinkit për ndihmë juridike falas për raste në lidhje me procesin arsimor, gjë që e tregon nevojën për aktivitete që të vazhdon rritja e ndërgjegjësimit për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për ta.

